



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 064/6
Prishtinë, më 26 mars 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 26 MARS 2009**

Seancën e kryesoi Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 81 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kryetari njoftoi deputetët me vendimin e Presidentit të Republikës, Fatmir Sejdiu, për emërimin e **Danush Ademit**, deputet i Kuvendit, nga PDAK , në vend të ish- deputetit Sabit Rrahmani.

Në fillim të seancës për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Gani Geci shprehu shqetësimin lidhur me rastin që kishte ndodhur ditë më parë në fshatin Karaçevë, komuna e Dardanës, ku qenët endacak kishin sulmuar një fëmijë, i cili më pas kishte vdekur. Ai kërkoi që organet përgjegjëse të marrin veprimet e nevojshme, që raste të ngjashme të mos përsëriten.

Ismet Beqiri pyeti pse nuk është radhitur në rend dite të seancës plenare rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Peticione lidhur me peticionin e qytetarëve kundër ngritjes së çmimit për energji elektrike?

Bahri Hyseni shprehu shqetësimin për mosfunksionimin e Këshillit Gjyqësor dhe Prokurial të Kosovës. Ai kërkoi që Kuvendi të marrë veprimet e nevojshme për funksionalizimin e këtij këshilli.

Myzejene Selmani, në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion shprehu shqetësimet lidhur me gjendjen e aseteve të ndërmarrjeve publike të Kosovës në territorin e ish-Jugosllavisë. Ajo kërkoi që Qeveria e Kosovës të ndërmarrë veprimet e nevojshme për t'i identifikuar astetet e Kosovës, të cilat ndodhen jashtë vendit për t'i kthyer në pronësi të saj.

Numan Baliq shprehu pakënaqësi për moszbatimin e Ligjit për organizimin e pushtetit lokal në komunën e Pejës. Ai kërkoi që gjatë procesit të decentralizimit të formohen komuna të reja në vendbanimet ku jetojnë boshnjakët, si Vitimirica etj.

Sadik Idriz, në emër të Komisionit për Punë, Shëndetësi dhe Çështje Sociale kërkoi që pika e 8-të të shtyhet për seancën tjetër të radhës.

Kryetari hodhi në votim propozimin e kryetarit të Komisionit për Shëndetësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër----- 2,
Abstenime-----5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që pika e 8-të - Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2004/50 për veprimtarinë private në shëndetësi, të shtyhet për seancën e ardhshme.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 12. mars 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Programit të Punës së Kuvendit për vitin 2009,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,
6. Rishqyrtimi i Ligjit për shpronësim,
7. Shqyrtimi i vërejtjeve të Presidentit në Ligjin nr. 03-L-118 për tubimet publike,
8. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 12 mars 2009

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 12 mars 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare

Kryetari i Kuvendit konstatoi mungesën e ministrave, Ahmet Shala, Lutfi Zharku, Enver Hoxhaj dhe Zenun Pajaziti.

Deputeti, Riza Smaka, parashtoi pyetje për ministrin e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj, lidhur me veprimin e operatorëve ilegalë të telefonisë, në Kosovë.

Ministri Limaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti, Riza Smaka, parashtoi pyetje për ministrin e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj, lidhur me marrjen e kodit telefonik për vendin tonë.

Ministri Limaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti, Gani Geci, parashtoi pyetje për ministrin e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj, lidhur me pagesën e taksës shtesë në emër të sigurimeve për automjete nga ana e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të punësuar në botën e jashtme.

Ministri Limaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Geci.

Deputetja, Myrvete Pantina, parashtoi pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Shiroka – Pula, lidhur me faktorët që kanë ndikuar në rritjen e koston së prodhimit të energjisë elektrike.

Ministrja Shiroka-Pula iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputeti, Driton Tali, parashtoi pyetje për ministrin e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj, lidhur me objektin e PTK-së në vendin e ashtuquajtur “Qafë”, në Prishtinë.

Ministri Limaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti, Driton Tali, parashtoi pyetje për ministrin e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj, lidhur me themelimin e Postë – Bankës në Kosovë.

Ministri Limaj i'u përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti, Riza Smaka, parashtroi pyetje për Kryeministrin zotin Hashim Thaçi, lidhur me pozitën kushtetuese të minoritetit malazias në Kosovë.

Kryeministri iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti, Naim Maloku, i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotit Mahir Yagcilar lidhur me mbikëqyrjen e ndotjes së ambientit që e shkakton “Ferronikeli” nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor.

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetit Maloku.

Deputetja, Nurishahe Hulaj, i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, zotit Mahir Yagcilar lidhur me riciklimin e mbeturinave në Kosovë.

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputetja, Kaqusha Jashari, i parashtroi pyetje ministrit të Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, z. Mahir Yagcilar, lidhur me hartimin e projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje në Kosovë.

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Jashari.

Deputetja, Kaqusha Jashari, i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotit Enver Hoxhaj, lidhur me vendimin e Qeverisë rreth moshës së pensionimit të profesorëve ordinarë.

Për shkak të mungesës së ministrit Hoxhaj, Deputetja Jashari nuk mori përgjigje.

Deputeti, Emrush Xhemajli, i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, zotit Ahmet Shala, lidhur me privatizimin e PTK-së.

Për shkak të mungesës së ministrit Shala, Deputeti Xhemajli nuk mori përgjigje.

Deputetja Gjylnaze Sylja, parashtroi pyetje për Kryeministrin zotin Hashim Thaçi, lidhur me emërimin e Zëvendës drejtorit dhe të Inspektorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Kryeministri iu përgjigj pyetjes së deputetes Sylja.

3. Shqyrtimi i Programit të Punës së Kuvendit për vitin 2009

Kryesuesi i seancës, Xhavit Haliti, i njoftoi deputetët e Kuvendit me Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2009.

Ai hapi debatin lidhur me Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2009.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2009 dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Enis Kervan, si dhe deputetët: Gjylnaze Sylja, Hydajet Hyseni, Edmond Rugova, Armend Zemaj, Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Riza Smaka, Myzejene Selmani, Adem Salihaj, Sala Berisha-Shala, Esat Brajshori, Gani Buçinca, Syzanë Nvobërdali, Fatmir Rexhepi, Zylfije Hundozi, Njomza Emini, Ismet Beqiri dhe Nurishahe Hulaj, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerime të deputetëve.

Kryetari hodhi në votim Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2009, me propozimet e dhëna nga deputetët. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----54,
Kundër-----22,
Abstenime..... 3.

Kryetari, konstatoi se Kuvendi, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Programi i Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009.
2. Në Programin e Punës së Kuvendit për vitin 2009 përfshihen edhe dy projektligje:
 - Projektligji për ish- të burgosurit politikë,
 - Ligji për të drejtat dhe detyrimet e deputetit.
3. Ngarkohet Departamenti Ligjor i Kuvendit që, në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Qeverisë, t’i saktësojë datat e procedimit të projektligjeve.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës ta prezantojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë.

Ministrja **Shiroka-Pula** tha se Projektligji është i një rëndësie të veçantë sepse do të mbështetet në zhvillimet e gjithëmbarshme ekonomike të vendit.

Ky projektligj përcakton procedurën e autorizimeve dhe atë të tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, të rrjeteve të reja të bartjes dhe të shpërndarjes së gazit, si dhe të linjave të reja direkte të energjisë elektrike.

Qëllimet themelore të këtij projektligji janë:

- 1) Themelimi i kornizës ligjore për procedurën e autorizimit dhe atë të tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, të rrjeteve të reja të bartjes dhe të shpërndarjes së gazit, si dhe të linjave të reja direkte të energjisë elektrike.
- 2) Themelimi i Komitetit tenderues të projektit të energjisë me mandat për të zbatuar dhe përmbyllur procedurën e tenderimit, ku Komiteti tenderues i projektit të energjisë do të ndër marrë procedura të tenderimit në pajtim me kriteret objektive dhe transparente.

Përmbajtja normative e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Rregullatorit të Energjisë është e sistemuar në 8 nene, duke respektuar parimet themelore të metodologjisë legislative dhe të teknikës juridike për hartimin e ligjit.

Andaj, propozoj që ky Projektligj të miratohet, në parim.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Mufera Sinik, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Mursel Halili dhe në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno” Vezira Emrush, si dhe deputetët: Gjylnaze Syla, Sala Shala, Myzejene Selmani, Ibrahim Makolli, Ethem Çeku, Ardian Gjini, Bahri Hyseni, Safete Hadërgjonaj, Gani Buqinca, Fatmir Regjepi, Emrush Xhemajli dhe Driton Tali, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse i këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----26,
Kundër-----40,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/9 për Rregullatorin e Energjisë.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për64,
Kundër..... 0,
Abstenime..... 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

6. Rishqyrtimi i Ligjit për shpronësim

Kryetari i njoftoi deputetët se në bazë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 30 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për shpronësim dhe Kuvendit i ka parashtruar Rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ai ftoi përfaqësuesin e komisionit që ta arsyetojë raportin.

Kryetarja e komisionit funksional, **Myzejene Selmani**, në emër të Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, i propozoi Kuvendit ta miratojë këtë projektligj.

Kryetari hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara nga Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Kryetari hodhi në votim projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për63,
Kundër.....0,
Abstenime..... 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

7. Shqyrtimi i vërejtjeve të Presidentit në Ligjin për tubimet publike

Kryesuesi njoftoi deputetët se Ligji për tubimet publike është miratuar në seancën plenare të mbajtur më 4 dhjetor 2008 dhe është proceduar për shpallje të Presidenti i Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 84, pika 6, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidenti e ka kthyer në rishqyrtim Ligjin për tubimet publike.

Komisioni funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri ka shqyrtuar vërejtjet e Presidentit në Ligjin për tubimet publike dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me Rekomandime.

Kryesuesi hodhi në votim Propozimin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për41,
Kundër..... 6,
Abstenime..... 4.

Kryesuesi tha se Kuvendi, me shumicë votash, nuk miratoi propozimin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri lidhur me vërejtjet e Presidentit në Ligjin për tubimet publike.

9. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Kryetari i njoftoi deputetët me propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Grupi Parlamentar i LDK-së kishte propozuar që deputeti **Arsim Rexhepi** të emërohet anëtar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në vend të deputetes **Fatmire Berisha**.

Kuvendi miratoi propozimin për zëvendësimin e anëtarit të komisionit parlamentar të cekur më lart.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**